



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, pika 11.3 të Rregullave Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit-02 shpenzimi i parave publike dhe të nenit 15.2 shkronja c të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2016, miratoi,

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR CAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJE TË MJETEVE BUXHETORE NGA KATEGORIA EKONOMIKE SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Neni 1

Neni 3 të Rregulloreve për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferë, nr.01/111-400 e datës 28 maj 2012, me këtë përmbajtje:

“Komuna ndan subvencione dhe transferë për fushat: kulturë, rini dhe sport, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, bujqësi dhe zhvillim rural, si dhe arsim”

I shtohen paragrafët në vijim;

“Komuna, në kuadër shërbimeve publike bënë subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës”.

“Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë, cakton periudhën e subvencionimit të shpenzimeve sipas paragrafit paraparak”.

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-26348
Podujevë,
30 mars 2016



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi